

**Aldosch-Farma sh.p.k.**

**Shënimet e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

*(Vlerat janë në Lekë)*

## **1. Informacion i përgjithshëm**

Shoqëria "Aldosch Farma" sh.p.k është themeluar më 3 mars 2003 dhe është regjistruar më 5 shkurt 2003 në Regjistrin e Shoqërive me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.28995

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është tregtimi me shumice dhe pakice, importi dhe eksporti i produkteve farmaceutike.

Kapitali nënshkruar i Shoqërisë është 200,100,000 lekë i cili zotërohet nga ortakët Aqif Hoxha. Administrator i Shoqërisë është Z. Aqif Hoxha.

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë me NIPT K31503045V. Selia qendrore e saj ndodhet në Rrugën "Myslym Keta" në ambjentet e Shoqërisë Antibiotik sh.a, Tiranë.

Më 27 shtator 2010 është hapur në Kosovë kompania ProMed sh.p.k me kapital 5,000 Euro e zotëruar 100% nga "Aldosch-Farma" sh.p.k .

ProMed sh.p.k ka numër regjistrimi 70698242 dhe numër fiskal 600597671.

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

### **2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### **2.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### **2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### **2.5. Vlerësime dhe gjykime**

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

## 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

### 2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

#### 2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

#### 2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

## 2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvec rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

## 2.7. Bazat e Konsolidimit

Filialet janë të gjitha subjektet (duke përfshirë njësitë ekonomike për qëllime të veçanta ) mbi të cilat Grupi ka fuqi për të qeverisur politikat financiare dhe operative, që në përgjithësi u atribuohen aksionereve që zoterojnë më shumë se gjysmën e të drejtave të votës. Ekzistenca dhe efekti i të drejtave votuese potenciale që janë aktualisht të ushtrueshme ose të konvertueshme janë konsideruar kur është bërë vlerësimi nëse Grupi kontrollon një njësi tjetër ekonomike. Filialet janë konsoliduar plotësisht që nga data në të cilën kontrolli i është transferuar Grupit. Metoda e koston është përdorur për të kontabilizuar blerjen e filialeve nga Grupi. Kostoja e blerjes është matur në vlerën e drejtë të aktiveve të dhëna , instrumentave të kapitalit neto të emetuara dhe detyrimeve të pësuara ose konstatuara në datën e këmbimit, plus kostot direkte të blerjes. Aktivitetet e identifikueshme të blera dhe detyrimet e konstatuara në një kombinim biznesi njihen fillimisht me vlerën e drejtë në datën e blerjes, pavarësisht nga interesi i pakicës. Tejkalimi i koston të blerjes mbi vlerën e drejtë të pjesës të grupit të aktiveve neto të identifikueshme njihet si emri i mirë. Transaksionet midis shoqerive të grupit, balancat dhe fitimet e përealizuara për transaksione ndërmjet shoqerive të grupit janë eliminuar. Gjithashtu janë eliminuar humbjet e përealizuara. Politikat kontabël të filialeve janë ndryshuar kur ka qene e nevojshme për t'u perputhur me politikat e miratuara nga Grupi.

### 3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

#### 3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
EUR/Lek	121.77	123.42
USD/ Lek	108.64	107.82

#### 3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

##### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

##### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(Vlerat janë në Lekë)

### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

##### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

##### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

##### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

##### *Kapitali themeltar*

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

##### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### 3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.4. Aktive afatgjata materiale

##### i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

##### iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20%

Toka nuk amortizohet .

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

##### iv. Ç'regjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

#### 3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

#### **3.7. Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka qira operative dhe qira financiare.

#### **3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

#### **3.9. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%). Tatimi mbi fitimin në Republikën e Kosovës është 10%.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë mbi fitimin.

#### **3.10. Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

**3. Politikat Kontabël (vazhdim)****3.11. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

**3.12. Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

**3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

**4. Mjete monetare**

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mjete monetare në bankë		
Llogari rrjedhëse	17,483,802	4,715,842
Depozita me afat	-	-
Mjete monetare në arkë	1,960,627	1,423,503
Likuiditete në udhëtim	56,400	56,400
	<u>19,500,829</u>	<u>6,195,746</u>

**5. Llogari të arkëtueshme tregtare**

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Klientë	434,707,454	354,392,633
	<u>434,707,454</u>	<u>354,392,633</u>

**6. Të tjera llogari të arkëtueshme**

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Paradhënie për punonjësit	0	0
TVSH e arkëtueshme	437,196	316,110
Tatimi mbi fitimin	16,993,616	0
Te tjera kerkesa per arketim	299,745,888	326,232,675
Të arkëtueshme nga ortaku	242,036,959	293,286,045
	<u>559,213,659</u>	<u>619,834,830</u>

**7. Inventari**

Inventari më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mallra	427,532,946	472,467,579
	<u>427,532,946</u>	<u>472,467,579</u>

**8. Parapagimet dhe shpenzime të shtyra**

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Parapagime per inventarë	287,223,480	232,553,744
Shpenzime te shtyra		0
	<u>287,223,480</u>	<u>232,553,744</u>



**Aldosch-Farma sh.p.k.**  
**Shënimet e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**  
*(Vlerat janë në Lekë)*

**9. Aktive afatgjata materiale**

<i>Kosto</i>	Toka	Ndërtesa	Instalime Teknike	Mobilje dhe orendi	Pajisje informatike	Mjete transporti	Të tjera	Totali
Gjendja më 1 janar 2018	167,537,402	-	-	5,257,265	7,010,962	32,372,224	20,072	212,197,925
Shtesa	-	-	1,828,433	-	69,325	-	-	1,897,758
Pakësime	-	-	-	-	-	(200,000)	-	(200,000)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>167,537,402</b>	<b>-</b>	<b>1,828,433</b>	<b>5,257,265</b>	<b>7,080,287</b>	<b>32,172,224</b>	<b>20,072</b>	<b>213,895,683</b>
Shtesa	-	-	-	0	193,213	8,253,532	-	8,446,744
Pakësime	(167,537,402)	-	-	0	0	0	-	(167,537,402)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>1,828,433</b>	<b>5,257,265</b>	<b>7,273,499</b>	<b>40,425,756</b>	<b>20,072</b>	<b>54,805,025</b>
<i>Amortizimi i akumuluar</i>								
Gjendja më 1 janar 2018	-	-	-	-	-	-	-	0
Amortizimi i vitit	-	-	-	3,626,111	5,533,345	22,113,274	15,278	31,288,008
Pakësime	-	-	-	334,453	553,556	2,040,263	958	2,929,230
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>3,960,564</b>	<b>6,086,901</b>	<b>23,976,354</b>	<b>16,237</b>	<b>34,040,055</b>
Amortizimi i vitit	-	-	91,422	190,497	465,420	2,591,244	767	3,339,350
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-	0
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>4,151,061</b>	<b>6,552,321</b>	<b>26,567,598</b>	<b>17,004</b>	<b>37,379,405</b>
<i>Vlera neto kontabël</i>								
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	-	-	-	-	-	-	0
Efekti i kursit të këmbimit nga përkthimet e degës	-	-	-	(102,587)	(60,398)	(114,405)	-	(277,390)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>167,537,402</b>	<b>-</b>	<b>1,828,433</b>	<b>1,194,114</b>	<b>932,989</b>	<b>8,081,465</b>	<b>3,835</b>	<b>179,578,238</b>
Efekti i kursit të këmbimit nga përkthimet e degës	-	-	-	(194,352)	109,911	(197,194)	-	(281,635)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>1,737,011</b>	<b>911,852</b>	<b>831,090</b>	<b>13,660,964</b>	<b>3,068</b>	<b>17,143,985</b>

**10. Aktive afatgjata jomateriale**

Gjendja e aktiveve afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2019 dhe më 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>AAJM</u>	<u>Total</u>
<b>Me kosto</b>		
Gjendja më 1 janar 2018	26,056,377	26,056,377
Shtesa	6,121,632	6,121,632
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	32,178,009	32,178,009
Shtesa	2,876,816	2,876,816
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	35,054,825	35,054,825
<b>Amortizimi</b>		
Gjendja më 1 janar 2018	14,882,700	14,882,700
Shtesa	2,412,538	2,412,538
Pakesime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	17,295,238	17,295,238
Amortizimi i vitit	4,838,205	4,838,205
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	22,133,443	22,133,443
Efeki i kursit të këmbimit nga përkthimet e degës	984,025	984,025
<b>Gjendja Neto më 31 dhjetor 2018</b>	<b>14,882,771</b>	<b>14,882,771</b>
<b>Gjendja Neto më 31 dhjetor 2019</b>	<b>11,937,357</b>	<b>11,937,357</b>

**11. Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit**

Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit(Promed) më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit(Promed)	701,000	701,000
	<b>701,000</b>	<b>701,000</b>

**12. Llogari të pagueshme tregtare**

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Furnitorë	34,240,133	29,032,360
Detyrimi tregtare ndaj paleve të lidhura	0	0
	<b>34,240,133</b>	<b>29,032,360</b>

**13. Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime**

Gjendja e të ardhurave të shtyra, parapagimet e klientëve më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Te ardhura të shtyra	197,420,924	184,824,834
	<b>197,420,924</b>	<b>184,824,834</b>

**14. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime tatimore	34,337	9,907,215
	<u>34,337</u>	<u>9,907,215</u>

**15. Të tjera detyrime**

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 për shoqërinë vijojnë si më poshtë :

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime ndaj punonjesve	1,153,738	1,880,005
Detyrime ndaj ortakeve	-	-
Te tjera detyrime	-	-
	<u>1,153,738</u>	<u>1,880,005</u>

**16. Hua afatgjata**

Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Hua afatgjata	347,513,437	570,092,759
Qera financiare	-	-
	<u>347,513,437</u>	<u>570,092,759</u>

**17. Kapitali**

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë Aldosch Farma sh.p.k është 200, 100,000 Lekë, 100 kuota ose 100% zotërohen nga Aqif Hoxha

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 201x</u>
Numri i kuotave	100	100
Vlera nominale (në LEK)	2,001,000	1,000
Kapitali i nënshkruar	<u>200,100,000</u>	<u>100,000</u>

Kapitali i shoqërisë ProMed sh.p.k është 5,000 Euro i zotëruar 100% nga Aldosch-Farma sh.p.k.

Rezerva ligjore është në vlerën 440,120 Lekë, njësoj si edhe vitin e kaluar.

Rezerva nga përkthimi i kurseve të këmbimit ka vlerën (20,521,677.75)Lekë.

Fitimet e mbartura më 31 dhjetor 2019 janë në vlerën 900,534,126.56 Lekë.

**18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga shitja e mallrave	1,702,626,762	1,828,954,257
	<b>1,702,626,762</b>	<b>1,828,954,257</b>

**19. Të ardhura të tjera nga shfrytëzimi**

Të ardhurat e tjera nga shfrytëzimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2018</u>
Të ardhura nga shitja e AQT	167,537,402	30,000
Te ardhura te tjera	2,198,142	2,558,057
	<b>169,735,544</b>	<b>2,588,057</b>

**20. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme**

Shpenzimet për lëndë të para dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2018</u>
Mallra	1,438,723,815	1,385,577,487
	<b>1,438,723,815</b>	<b>1,385,577,487</b>

**21. Të tjera shpenzime**

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më</u> <u>31 dhjetor 2018</u>
Blerje energji, avull, ujë, karburant	5,336,158	5,730,221
Shpenzime qeraje	26,933,056	23,602,150
Mirëmbajtje dhe riparime	1,956,642	2,756,458
Sigurime	1,282,119	2,357,996
Blerje të ndryshme, kancelari etj	2,175,577	2,234,470
Shërbime nga të tretë	984,000	1,294,937
Licensa dhe koncesione	-	1,276
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,040,513	1,097,018
Shpenzime marketingu	1,408,029	18,153,122
Shpenzime për pritje dhe perfaqesime	-	258,592
Shpenzime transporti	2,802,083	1,782,695
Komisione bankare	337,228	361,263
Sponsorizime	1,108,842	1,139,830
Taksa të ndryshme	1,237,570	682,925
Shpenzime të ndryshme dhe të panjohura	24,588,312	25,071,944
	<b>71,190,128</b>	<b>86,524,898</b>

**22. Shpenzime të personelit**

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime për paga	35,764,934	39,879,303
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	2,691,268	2,579,449
	<b>38,456,202</b>	<b>42,458,751</b>

**23. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi**

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime amortizimi dhe konsumi	8,177,601	5,341,640
	<b>8,177,601</b>	<b>5,341,640</b>

**24. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit**

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjokat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Gjoka te ndryshme dhe kamatvonesa	2,916,006	3,420,047
	<b>2,916,006</b>	<b>3,420,047</b>

**25. Shpenzime financiare**

Shpenzimet dhe të ardhurat nga interesi si dhe rezultati nga kurset e këmbimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime interesi	30,977,691	52,786,015
Humbje nga kursi këmbimit	-	-
Te ardhura nga interesi	-	-
Shpenzim për shitje AQT	167,537,402	22,817
	<b>198,515,093</b>	<b>52,808,832</b>

**Aldosch-Farma sh.p.k**  
**Shënimet e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**  
*(Vlerat janë në Lekë)*

**26. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	E konsoliduar 31 dhjetor 2019	Aldosch-Farma 31 dhjetor 2019	ProMed sh.p.k 31 dhjetor 2019	E konsoliduar 31 dhjetor 2018	Aldosch-Farma 31 dhjetor 2018	ProMed sh.p.k 31 dhjetor 2018
<b>Fitimi para tatimit</b>	114,383,460.50	71,164,784.57	43,218,675.93	255,410,658.64	215,007,024	40,403,635
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	28,747,611	3,350,870	25,396,741	26,038,895	4,418,453	21,620,442
Gjoha dhe dëmshpërblime	477,353	14,290	463,063.02	331,941	3,333	328,607.81
Shpenzime të tjera	25,824,715	891,037	24,933,678	22,618,848	1,327,014	21,291,834
Shpenzime të panjohura për autovetura	-	-	-	-	-	-
Humbje nga shitja e AAGJ	-	-	-	-	-	-
Kamatëvonesa	2,445,543	2,445,543	-	3,088,106	3,088,106	-
Shpenzime te panjohura per interesa	-	-	-	-	-	-
<b>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</b>	143,131,072	74,515,655	68,615,417	281,449,554	219,425,477	62,024,077
<b>Tatim fitimi @15% (@10%)</b>	114,383,461	71,164,785	43,218,676	255,410,659	215,007,024	40,403,635
<b>Fitimi pas tatimit (Fitimi neto)</b>	18,038,890	11,177,348	6,861,542	39,116,229	32,913,822	6,202,408
	96,344,571	59,987,436	36,357,134	216,294,429	182,093,202	34,201,227

## 27. Angazhime dhe pasiguri

### *Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2019 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

## 28. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.